



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.229/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 14.03.2022 me numër A.nr.229/2022 të parashtruar nga grupi ankuesve të përfaqësuar nga ankuesja me adresë kundër organit të punësimit/Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike-administrative "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datën 12.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.229/2022 e datës 14.03.2022 e parashtruar nga grupi ankuesish të përfaqësuar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimit nr.1B/350 i datës 07.12.2021 i nxjerr nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.
- III. OBLIGOHET Njësia e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Arsimit në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, që brenda afatit ligjor t'i bëjë të gjitha ndryshimet e nevojshme në listën e pagave me qëllim të pagesës së shtesës në vlerës prej 100 Euro për ankuesit, njëkohësisht tua bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive sipas Vendimit nr.1B/350 të datës 07.12.2021.
- IV. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi sipas pikës II të Diapozitivit, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### Ar sy e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 04.05.2012, me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 07.10.2016, me koeficient 16, në pozitën "Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 16.07.2013, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit SIA-Prishtine", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 10.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor për nivelin 6-9 në Mitrovicë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 30.11.2011, me koeficient 9 në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit të Arsimit - (SIA)-Pejë, në Departamentin e Inspektimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 24.01.2017, me koeficient 7 në pozitën "Inspektor i Arsimit SIA-Prizrenë", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 03.08.2016, me koeficientin 8 në pozitën "Inspektore Arsimit në Qendrën e Inspektoratit të Arsimit në Ferizaj", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, me koeficient 9 në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit të Arsimit -Gjilanë", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore për Nivelin 6-9 në Gjakovë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit,

e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 03.05.2012, me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 06.06.2012, me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 20.02.2017, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore e Arsimit", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.10.2021, me koeficientin 8 në pozitën "Inspektore e Arsimit në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit SIA për Prishtinë", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 04.05.2012 me koeficient 8, në pozitën "Inspektore per Nivelin 0-5 dhe Arsim Special -Prishtine", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 24.10.2011 me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit", me koeficient 8 në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.06.2012, me koeficient 7, në pozitën "Zyrtar i arsimit të mesëm të lartë", në Departamentin e Administratës së Arsimit Para

universitar, e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 16.07.2013 me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit SIA-Prishtine", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 03.08.2016, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit në Qendrën e Inspektoratit të Arsimit -Prishtinë", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 10.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor për Arsim Profesional-Mitrovicë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 03.08.2016, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit në Qendrën e Inspektoratit të Arsimit-Mitrovicë", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 03.08.2016, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit në Sektorin e Pejës,, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 01.06.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore për Nivelin 0-5, dhe Arsimin e Komuniteteve në Pejë", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 01.06.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit në Pejë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 17.01.2014, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit -Prizrenë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 07.05.2013, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit për Komunitete SIA-Prizrenë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit -Prizrenë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit -Prizrenë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor për Nivelin 6-9 për Arsim të Komuniteteve dhe të Drejtave të Njeriut në Gjuhën Boshnjake-Prizrenë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore për nivelin 0-5 dhe Arsimin të Komuniteteve -Gjilanë", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 27.04.2018, me koeficient 7 në pozitën "Inspektor i Arsimit ", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 13.03.2013, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit SIA-Prishtine", në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 10.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore për Nivelin 0-5 për Arsim të Komuniteteve - Mitrovicë", në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, me 14.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoll 1329/2022, me pretendime ankimore për realizimin e të drejtës në bazë të nenit 26 të Ligjit Nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, për pagesën shtesë, për rrezikshmërinë për

kushte specifike të punës, duke pretenduar se Ministria e Financave gjegjësisht Thesari nuk ka aprovuar zbatimin e Vendimit nr.1B/350 të datës 07.12.2021 të nxjerre nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për realizimin e shtesës në pagë në shumë prej 100 euro, për nëpunësit e punësuar në Inspektoratin e Arsimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.03.2022, ankesën e ankueseve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e cila me datë 01.04.2022 dhe të plotësuar me datë 10.05.2022, të dërguar në Këshill, me të gjitha shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 14.03.2022 me numër protokoll 1329/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i ankueses i datë 11.03.2022; Lista e të punësuarve në sektorin e Inspektoratit të Arsimit Zyra Qendrore e IA; Lista e të punësuarve në sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Prishtinë; Lista e të punësuarve në sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Mitrovicë; Lista e të punësuarve në sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Pejë; Lista e të punësuarve në sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Prizrenë; Lista e të punësuarve në sektorin e Inspektoratit të Arsimit në SIA Ferizaj; Lista e të punësuarve në sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Gjilan; Lista e të punësuarve në sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Gjakovë; kopje Ligji Nr.06/L-046; Formular i shpenzimeve i departamentit ose Sektorit i datë 19.10.2018; Formular i shpenzimeve i departamentit ose Sektorit i datë 21.02.2020; Formular i shpenzimeve i departamentit ose Sektorit i datë 19.10.2021; Kërkesë e datë 21.02.2019; E-mail i datës 25.02.2019; Plotësim i kërkesës i datë 26.02.2019 gjithsejtë 40 nëpunës; E-mail i datë 26.02.2019, Kërkesë e datë 05.03.2019 gjithsejtë 40 nëpunës; Plotësim i kërkesës e datës 08.03.2019 gjithsejtë 40 nëpunës të listuar; Ripërtëritje e kërkesës e datës 03.04.2019; E-mail i datës 03.05.2019; Kërkesë për realizimin e shtesës në pagë e datës 02.09.2019; Kërkesë për realizimin e shtesës në pagë e datës 04.11.2019; Kërkesë për realizimin e shtesës në pagë e datës 16.08.2019, me Përgjigje e datës 26.08.2019 ne kërkesë të datës 16.08.2019; Ankesë për mos realizimin e shtesës në pagë e datës 04.11.2019 për KPMSHCK-në; Kërkesë për realizimin e shtesës në pagë e datës 23.01.2020, me përgjigje të datës 28.01.2020; Përsëritje në kërkesë e datës 20.05.2020; Kërkesë për realizimin e shtesës në pagë e datës 15.06.2020; Miratim i kërkesës e datë 02.11.2020; Kërkesë për realizimin e shtesës në pagë e datës 29.03.2021; Kërkesë për realizimin e shtesës në pagë e datës 23.06.2021; Kërkesë për përfaqësimin në realizimin e shtesës në pagë e datës 15.11.2021; Kërkesë për realizimin e shtesës në pagë e datës 15.11.2021 për inspektoratin e punës; Vendimi datë 07.12.2021 nr. 01B/350 lëshuar nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Kërkesë e datës 07.12.2021 për ekzekutimin e vendimit nr. 01B/350 të datë 07.12.2021 (gjithsejtë 300 nëpunës në listë); E-mail i datë 07.12.2021; E-mail i datë 06.12.2021; E-mail përgjigje e datës 14.12.2021; Shkresë e datës 15.12.2021 sqaruese për MF-Thesarin; Informata e datë 01.12.2021 për Inspektoratin e punës; E-mail i datës 12.03.2022; Përgjigje në ankesë e datës 01.04.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Lista e pagave e datës 01.12.2021 deri me datës 31.12.2021; Akt emërimit të datës 04.05.2012, me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit"; Akt emërimit të datës 07.10.2016, me koeficient 16, në pozitën "Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit", Akt emërimi i datës 03.05.2012, me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit", Akt emërimi i datës 06.06.2012, me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit"; Akt emërimit të datës 20.02.2017, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore e Arsimit", Akt emërimi I datës 16.07.2013, me koeficient

8 në pozitën "Inspektor i Arsimit SIA-Prishtinë"; Akt emërimi I datës 24.10.2011 me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit", Akt emërimin të datës 13.03.2013, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit SIA-Prishtinë"; Akt emërimin të datës 11.06.2012, me koeficient 7, në pozitën "Zyrtar i arsimit të mesëm të lartë"; Akt emërimi I datës 04.05.2012 me koeficient 8, në pozitën "Inspektore për Nivelin 0-5 dhe Arsim Special -Prishtinë"; Akt emërimi i datës 16.07.2013 me koeficient 8, në pozitën "Inspektore e Arsimit SIA-Prishtinë"; Akt emërimin të datës 03.08.2016, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit në Qendrën e Inspektoratit të Arsimit -Prishtinë"; Akt emërimi i datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit të Arsimit -Gjilanë"; Akt emërimin të datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore për nivelin 0-5 dhe Arsimit të Komuniteteve -Gjilanë"; Akt emërimin të datës 27.04.2018, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit"; Akt emërimi i datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit -Prizrenë"; Akt emërimi i datës 07.05.2013, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit për Komunitete SIA-Prizrenë"; Akt emërimin të datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor për Nivelin 6-9 për Arsim të Komuniteteve dhe të Drejtave të Njeriut në Gjuhën Boshnjake-Prizrenë"; Akt emërimin të datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit -Prizrenë"; Akt emërimin të datës 17.01.2014, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit -Prizrenë"; Akt emërimi i datës 24.01.2017, me koeficient 7 në pozitën "Inspektor i Arsimit SIA-Prizrenë"; Akt emërimin të datës 10.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore e për Nivelin 0-5 për Arsim të Komuniteteve -Mitrovicë"; Akt emërimin të datës 10.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor për Arsim Profesional-Mitrovicë"; Akt emërimi i datës 10.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor për nivelin 6-9 në Mitrovicë"; Akt emërimin të datës 03.08.2016, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit në Qendrën e Inspektoratit të Arsimit-Mitrovicë"; Akt emërimi i datës 30.11.2011, me koeficient 9 në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit të Arsimit -(SIA)-Pejë"; Akt emërimi i datës 01.06.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektor i Arsimit në Pejë"; Akt emërimi i datës 01.06.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore për Nivelin 0-5, dhe Arsimin e Komuniteteve në Pejë"; Akt emërimi i datës 11.05.2012, me koeficient 8 në pozitën "Inspektore për Nivelin 6-9 në Gjakovë"; Akt emërimin të datës 03.08.2016, me koeficientin 8 në pozitën "Inspektore Arsimit në Qendrën e Inspektoratit të Arsimit në Ferizaj"; Akt emërimi i datës 11.10.2021, me koeficientin 8 në pozitën "Inspektore e Arsimit në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit SIA për Prishtinë"; Prova shtesë e datë 10.05.2022 dhe me e-mail sipas kërkesës se datës 06.05.2022 .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesat e grup-ankuesve të përfaqësuar nga ankuesja *janë të bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se me datë 07.12.2021 Inspektorati i Arsimit ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 1223 , tek zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave -Thesarit për mes Ministres së Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për ekzekutimin e Vendimit nr.1B/350 të datës 07.12.2021 të nxjerrë nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ku është caktuar shtesa në pagën bazë për rrezikshmëri në punë për Inspektorët e Arsimit në MASHT-të në shumë prej 100 euro, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 26 të Ligjit Nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, ku është e përcaktuar se, *citohet: "1. Inspektorit të Arsimit i njihet e drejta e marrjes së pagës shtesë mbi pagën bazë në emër të rrezikshmërisë për kushtet specifike të*

*punës" 2. Shtesat sipas paragrafit 1 të këtij neni do të bëhen sipas dispozitave të Ligjit për shërbimin civil dhe Ligjit për pagat e nëpunësve civil".*

Lidhur me këtë, përmes komunikimit elektronike të datës 14.12.2021 Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Financave, ka dhënë përgjigje se zbatimi i Vendimit nr.1B/350 të datës 07.12.2021 për Inspektoratin e Arsimit, citoj: *kërkesa nuk mund të realizohet tani, mbetet në pritje për shkak se gjenden në fund të vitit fiskal dhe para ndarjes së buxhetit, gjegjësisht para hyrjes në fuqi të ligjit për buxhetin e vitit 2022"*, për të cilën përgjigje me datë 15.12.2021 Drejtori i Përgjithshëm në Inspektoratin e Arsimit, ka dhënë sqarime shtesë me numër reference 10/1274, se Inspektorati i Arsimit në vazhdimësi ka bërë kërkesa për realizimin e pagesës mbi rrezikshmërinë në punë edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-133 për ndarjen Buxhetore për Buxhetin Republikës së Kosovës për vitin 2019, përmes Ministrisë së Administratës Publike, të cilët më pas kanë rekomanduar që shqyrtohet mundësia eventuale në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë së Ekonomisë dhe Financave, dhe Zyrën e Kryeministrit, për të gjetur zgjidhje deri në fillimin e zbatimit të Ligjit për Paga në Sektorin Publik, për të cilën shkresë Inspektorati i Arsimit gjegjësisht Drejtori i Përgjithshëm, deri më tani nga ana e Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave, nuk ka pranuar përgjigjur lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve.

Lidhur me këtë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 27.04.2022 ka dërguar kërkesë për prova shtesë përmes E-mailit zyrtar, tek Inspektorati i Arsimit, duke u lidhur me përgjigjen e datës 14.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm -Thesarit të Kosovës, sipas kërkesës ref.10/nr.protokolli 1233 të datës 07.12.2021, për zbatimin e Vendimit nr.01B/350 të datës 07.12.2021, që lidhen me ndarjen buxhetore për Inspektoratin e Arsimit për çështjen e realizimit të shtesës në pagë për rrezikshmërinë në punë për stafin e Inspektoreve të Arsimit, lidhur dhe me sqarimin e dhënë me datë 15.12.2021, duke u lidhur për faktin se Drejtoria e Thesarit të Ministrisë së Financave, pas aprovimit të ndarjes Buxhetore për Buxhetin Republikës së Kosovës për vitin 2022, dhe pasi që me datë 31.12.2022 është hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2022, nuk ka dhënë përgjigje në këtë kërkesë.

Referuar Vendimit nr.1B/350 të datës 07.12.2021 të nxjerre nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura neni 11 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Ministria është përgjegjëse për të gjitha funksionet administrative në fushën përkatëse të përgjegjësisë, përveç nëse nuk u janë deleguar institucioneve të tjera të administratës shtetërore sipas ligjit"* si dhe neni 15 paragrafi 1 i të njëjtit ligj që përcakton se: *"Ministria drejtohet nga ministri dhe organizohet në këto nivele"* ndërlidhur me neni 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.4 si dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ku përcaktohet se: *"Ministri, në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, politikat dhe udhëzimet e përcaktuara nga Qeveria apo Kryeministri: 1.1. Udhëheq dhe përfaqëson ministrinë; 1.4 Nxjerr vendime, akte nënligjore dhe lidhë marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë; dhe 2. Gjatë kryerjes së përgjegjësisë dhe funksioneve të tij, ministri kujdeset që ministria që e udhëheq: 2.2 Të planifikojë qartë buxhetin dhe formulojë prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga buxheti i Kosovës dhe*

nga burime të tjera" shtuar faktin kësaj se në përgjigjen e datës 14.12.2021 Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës ka lënë të kuptohet se kërkesa është e ligjshme lidhur me kompensimin në vlerë prej 100 Eurove për inspektorët e arsimit referuar vendimit të datës Vendimit nr.1B/350 të datës 07.12.2021 të nxjerre nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Andaj, mbi bazën e të gjeturave të pasqyruara si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Arsimit në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, obligohet që brenda afatit ligjor të konfirmojë ndarjen e buxhetit sipas përgjigjes së datës 14.12.2021 Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, për zbatimin e Vendimit nr.1B/350 të datës 07.12.2021 të nxjerr nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për kompensimin e shtesës në pagë në shumë prej 100 euro, respektivisht të bëjë edhe kompensimin e shtesës në mënyrë retroaktiv nga data 07.12.2021, për nëpunësit civil në Inspektoratin e Arsimit/MASHT nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.229/2022.

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses (grupi i ankuesish);
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin e Arsimit në Ministrinë e Arsimit Shkencës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.